VENDIM
Nr. 953, datë 2.12.2020

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË, PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE TIRANË, TË PASURIVE ME NR. 8/72, 8/700, 8/582, ZONA KADASTRALE 8270, TË PASURIVE ME NR. 3/221, 3/219, ZONA KADASTRALE 8210, DHE TË PASURISË ME NR. 2/21, ZONA KADASTRALE 8150

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 5, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, për Njësinë Administrative Tiranë, të pasurive me nr. 8/72, 8/700, 8/582, zona kadastrale 8270, të pasurive me nr. 3/221, 3/219, zona kadastrale 8210, dhe të pasurisë me nr. 2/21, zona kadastrale 8150, sipas formularëve, gjithsej 3 (tri) fletë, dhe planvendosjeve, bashkëlidhur këtij vendimi, me qëllim për t'u përdorur në fushën e arsimit, të sportit, të zhvillimit ekonomik dhe të shërbimeve.
2. Pasuritë e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi i shtohen listës përfundimtare të pjesshme të pronave të paluajtshme publike shtetërore, bashkëlidhur vendimit nr. 219, datë 21.3.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare të pjesshme (pjesa e parë + pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të njësisë administrative Tiranë, Bashkia Tiranë, të qarkut të Tiranës", të ndryshuar.
3. Ngarkohen Bashkia Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe


PLANVENDOSJE

PLANVENDOSJE

BASHKIA TIRANË

A. IDENTIFIKIMI I PASURISË

PLANVENDOSJE

BASHKIA: TIRANË

A. IDENTIFIKIMI I PASURISË

ZONA KADASTRALE: 8150
NR. I PASURISË: 2/21 VOL. 26 FQ. 248
INDEKS HARTE: TR-O-12
SHKALLA: 1:500
ADRESA E PASURISË: Rrethi: Tiranë

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Bashkia Tirane

Identifikoi: **Albana Hoxha** **Pergj/Sektori** / **Raif Halidini** **Specialist**
Ervin Nikolla **Drejtor I Deleguar**
Supervizoi: **Alban Dokushi** **Drejtor**

Fusha e perdorimit te Prones: Zhvillim ekonomik, Sherbime, Prodhim ,Sport.

Aprovoi: **Erjon Veliaj** **Kryetar**

Nr. Rend.	A			B			C			
	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones m2	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
29	8150 O- 12 v 26,fq248	2/21	Truall Ndertese	DPNR.1 PQ Godina e Punetoreve Bashkia Tirane	132	132	Sherbim	Bashkia Tirane	Bashkia Tirane	